

*SHOQERIA TREGTARE ME ORTAKERI*  
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“NATURAL HEALTH ” Sh. p. k

Durres – Albania

**KONTRATE THEMELIMI**

Ne Durres, sot me daten 01/03/2018 (dymije e tetembehjete), dite e Ejte,ne shtetasit shqipetar me keto identite:

1. **Z. Gert Reka**,atesia Abedin, amesia Fatbardha,i datelindjes 10.03.1985, lindur ne Durres dhe banues ne Lagje nr 5 Rruga Dalip Tabaku, nr telefoni 698077888, Nr karte ID I50310072W
2. **Ardi Bit**a ,atesia Perikli,amsia Aferdita, i datelindjes 11.05.1985,banues ne Tirane rr.Hosxha Tasim nr. shtepise 108. Nr karte ID I505110240

duke u bazuar ne:

- \* Vullnetin tone te lire, te plote, te singerte, mirekuptues dhe ne inisiativen e lire private,
- \* Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,
- \* Ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare”,
- \* Ne Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”

Vendosem si me poshte:

**NENI 1**

Shoqeria formohet nga ne Ortaket themelues me emrin “NATURAL HEALTH ” Shpk Durres-Albania, emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

**NENI 2**

Selia Qendrore e Shoqerise “NATURAL HEALTH” Shpk eshte ne Durres ne adresen: Lagje nr 5 Rruga Dalip Tabaku DURRES, Numri pasurise 7/231zona kadastrale 8513.

**NENI 3**

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithe juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit ne cdo vend te Komunitetit European, etj.

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve mund te krijohen ose anulohen (ne rast se jane celur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte shtetit.

Njesite e tjera Strukturore te Shoqerise, si Dege apo Perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje te tille e parashikon dhe lejon edhe legjislacioni i vendeve te huaja, **normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.**

**NENI 4**

**Kapitali Themeltar** i Shoqerise fillestar eshte **200. 000 Lek** (dyqindemije) Lek ( sipas ligjit kapitali nuk mund te jete me i vogel se 100 leke\*) Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme :

Shoqeria “NATURAL HEALTH” sh.p.k ka dy ortak.– Ortaket themelues z.Gert Reka zoterues i 1 (nje ) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise dhe Ortaku z.Ardi Bit a zoterues i 1 (nje ) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

**Kontributet ne kapitalin e shoqerise jane ofruar si me poshte:**

1. **Ortaku z.Gert Reka** ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 100.000 (Njeqind mije leke) dhe **ortaku Ardi Bit**a zoterues i 1 (nje ) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise Ky kapital eshte i vlefshem per regjistrimin e shoqerise sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"

Ortaket kan pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronesie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjeter te fituar ne rruge te ligjshme.

Shoqeria pergjigjet vetem me Kapitalin e saj.

**NENI 5**

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me Letra me vlere dhe derdhja e Kapitalit themeltar te Shoqerise, behet para kerkeses drejtuar **Qendres Kombetare te Rregjistrimit** per njohjen dhe rregjistrimin e saj si Person Juridik.

**NENI 6**

**Kohezgjatja** e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise eshte **PA AFAT**, duke filluar aktivitetin e saj nga dita e Shpalljes se saj Person Juridik.

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshoj, dhe ky Vendim i dergohet menjehere per depozitim Qendres Kombetare te Rregjistrimit, kompetente per te bere shenimet e nevojshme ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare.

**NENI 7**

Shoqeria e zhvillon veprimtarin e saj tregtare ne perputhje te plote me Legjislacionin shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e kesaj Kontrate Themelimi si dhe Statutin e saj.

**NENI 8**

Shoqeria çel Llogari Bankare ne leke vendi dhe çdo lloj valute, ne Banka vendase ose te huaja, private apo shteterore, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj.

Ortaket dhe Administratori Pergjithshem i caktuar prej tyre, depozitojne faksimilet e firmave te tyre origjinale ne Bankat ku eshte çelur llogaria dhe terheqja e pjeseve te saj behet kur Çeku bankar eshte firmosur nga njeri Ortak qe eshte caktuar dhe Administratori i Shoqerise, dhe ne rastin kur Ortaket kane caktuar me shume se nje Administrator, i cili eshte jashte ortakerise, ceku bankar dhe cdo likuidim apo pagese nenshkruhet nga Ortaku qe eshte Administrator i Pergjithshem i Shoqerise dhe nga Administratori jashte Shoqerise.

**NENI 9**

**Pjeset e Kapitalit Themelor**, jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave te Kodit Civil.

Ortaket kane te drejte qe te transferojne jashte territorit te Republikes Shqiperise pjeserisht apo teresisht Kontributet e saj perfshire dhe Fondet e Kontributet ne natyre.

Transferimet e pjeseve te Kapitalit Themelor, duhet te jene te vertetuara me Kontrate Noteriale dhe per nje gje te tille Ortaket duhet te marrin paraprakisht Vendim me shkrim, i cili ushtron efektet juridike vepruese te tij, vetem ne rast se eshte legalizuar nga nje Noter.

Shoqeria dhe te tretet, duhet te respektojne keto Transferime sapo tu behen te ditura.

#### NENI 10

**Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregetar ne keto Drejtime:**

-Inport-Eksport,distribution te produkteve kozmetike natyrale dhe shtesave ushqimore me origjine bimore dhe organike,tregtimin e tyre me shumice dhe pakcie.

#### NENI 11

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqipetar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjetere tregetare si brenda vendit dhe jashte shtetit.

#### NENI 12

**Asambleja e Ortakeve** eshte Organi me i larte **Drejtes dhe Vendimor** i Shoqerise dhe ajo ushtron te gjitha kompetencat qe Ligji "Per Shoqerite Tregetare" i njeh Asamblese se Ortakeve qe jane krijuar me Ortakeri.

Ortaket ne mirekuptim dhe duke vene paraprakisht ne dijeni njeri tjetrin mund t'ja delegojne Kompetencat nje ose me shume Administratoreve te caktuar prej tyre ose dhe nje Personi fizik apo Juridik, vendas apo te huaj dhe jashte ortakerise se Shoqerise, mbi bazen e **Prokures**, te bere me akt noterial.

#### NENI 13

Administrator i Pergjithshem i Shoqerise, caktohet :


**Z.Gert Reka** , shtetas shqipetar, atesia Abedin, amesia Fatbardha,i datelindjes 10.03.1985, lindur ne Durres dhe banues ne Lagje nr 5 Rruga Dalip Tabaku,me n umer karte indentiteti I50310072W dhe nr telefoni 698077888.

#### NENI 14


**Kjo Kontrate Themelimi** u redaktua ne 5 ekzemplare me permbejtje dhe vlere te njenjta juridike ne gjuhen shqipe dhe eshte i vlefshem de jure, kur ne te gjitha faqet e tij eshte vene emri, mbiemri dhe firma origjinle e Ortakeve Themelues.

ORTAKET THEMELUES I SHOQERISE TREGTARE  
MIRATUES I KESAJ KONTRATE THEMELIMI

( GERT REKA )

GERT REKA  


( ARDI BITA )

Ardi Bitar  


# K E R K E S E

## PER RREGJISTRIMIN PERSON JURIDIK

**K E R K U E S:** Administartori i Shoqerise Tregtare "NATURAL HEALTH" Shpk Durres.

**1.Z. Gert Reka**,atesia Abedin, amesia Fatbardha,i datelindjes 10.03.1985, lindur ne Durres dhe banues ne Lagje nr 5 Rruga Dalip Tabaku, nr telefoni 698077888.

**2.Z.Ardi Bita** ,atesia Perikli,amsia Aferdita, i datelindjes 11.05.1985,banues ne Fier fshati Vaikan.

**O B J E K T I:** Njohjen dhe rregjistrimin Person Juridik te Shoqerise tregtare vendase me Pergjegjesi te Kufizuar dhe me Ortakeri "NATURAL HEALTH" Shpk Durres

**BAZAT JURIDIKE :** Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ne Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 per "QKR-ne"

**DREJTUAR: QENDRES KOMBETARE TE RREGJISTRIMIT**

**D U R R E S**

Ne shtetasit:

**1.Z. Gert Reka**,atesia Abedin, amesia Fatbardha,i datelindjes 10.03.1985, lindur ne Durres dhe banues ne Lagje nr 5 Rruga Dalip Tabaku, nr telefoni 698077888.

**2.Z.Ardi Bita** ,atesia Perikli,amsia Aferdita, i datelindjes 11.05.1985,banues ne Fier fshati Vaikan,kemi krijuar me Ortakeri shoqerine tregtare vendase me pergjegjesi te kufizuar "NATURAL HEALTH" Shpk Durres-Albania.

**Kapitali Themeltar** i fillestar Shoqerise eshte **200. 000 Lek** (dyqindemije) Lek ( sipas ligjit kapitali nuk mund te jete me i vogel se 100 leke\*) Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme :

**Ortaku z.Gert Reka** ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 100.000 (Njeqind mije leke) dhe ortaku **Ardi Bita** zoterues i 1 (nje ) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise Ky kapital eshte i vlefshem per regjistrimin e shoqerise sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"

**Kohezgjatja** e Shoqerise Tregtare eshte **PA AFAT.**

**Selia Qendrore** e Shoqerise eshte ne Durres ne adresen Lagje nr 5,Rruga Dalip Tabaku Durres, Numri pasurise....., zona kadastrale .....

**Administratori Pergjithshem i Shoqerise**, eshte caktuar ortaku **Z.Gert Reka**,atesia Abedin, amesia Fatbardha,i datelindjes 10.03.1985, lindur ne Durres dhe banues ne Lagje nr 5 Rruga Dalip Tabaku, nr telefoni 698077888

**Shoqeria** zhvillon aktivitetin e saj, sipas objektit te percaktuar ne Kontraten e themelimit dhe statutin e shoqerise.

Bashkelidhur me kete Kerkese dergohen Kontrata e Themelimit dhe Statuti i Shoqerise si dhe Vertetimi i Depozitimit te Kapitalit themeltar.

Me besimin se kjo kerkese ligjore do te merret parasysh, ju faleminderit per mirekuptimin.

Durres me ...01.. /...03..../2018....

**Administratori Pergjithshem**

i Shoqerise Tregtare "NATURAL HEALTH" Shpk Durres

( Gert Reka )